

VENDIM
Nr. 37, datë 19.1.2022

**PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË MARRËVESHJES SË FINANCIMIT
NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E
FINANCIVE DHE EKONOMISË (MARRËSI), DHE *KfW FRANKFURT AM
MAIN (KfW)*, PËR PROGRAMIN “PROMOVIMI I ENERGJIVE TË
RINOVUESHME DHE EFICIENCËS SË ENERGJISË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 19 e 23, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave.

VENDOSI:

Miratimin e ndryshimit të marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (marrësi), dhe *KfW Frankfurt am Main (KfW)*, për programin “Promovimi i energjive të rinovueshme dhe eficiencës së energjisë”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 3
Tiranë, Shqipëri
Faks: +355 4222 8494

Zona e Biznesit
KfW Entwicklungsbank
Dr. Niels Kemper
Tel: +49 69 7431-2626
Faks: +49 69 7431-3490
niels.kemper@KfW.de

Datë 15.9.2020

Marrëveshja Financiare

Data: 10 janar 2006
Shuma: 7,000,000.00 euro
BMZ-nr. 2004 66 276

Ndryshim i Marrëveshjes së Financimit

Kjo letër i referohet Marrëveshjes së Financimit për shumën 7,000,000.00 euro (të ndryshuar herë pas here) (“Marrëveshja e Financimit”), e cila është nënshkruar në datën 10 janar 2006, ndërmjet KfW-së dhe Republikës së Shqipërisë në cilësinë e Marrësit, në kuadër të programit “promovimi i energjive të rinovueshme dhe eficiencës së energjisë”.

Në datën 31 gusht 2020, sipas Marrëveshjes së Financimit, janë disbursuar 5,738,525.40 euro (nga shuma 7,000,000.00 euro). Si rrjedhojë, propozojmë amendimin e Marrëveshjes së Financimit, si më poshtë, me qëllim garantimin e kuadrit ligjor për disbursime të mëtejshme deri në datën 31 dhjetor 2021.

Ne propozojmë si më poshtë:

Seksioni 1
Interpretimi

Në bazë të ndonjë dispozite të shprehur për të kundërtën në këtë letër ose nëse konteksti kërkon ndryshe, termat me germa të mëdha, të përcaktuara në Marrëveshjen e Financimit, kanë të njëjtin kuptim në këtë letër.

Seksioni 2

Amendimet e Marrëveshjes së Financimit

2.1 Dispozitat që vijojnë të Marrëveshjes së Financimit do të amendohen, si më poshtë:

a) Neni 2.2 do të fshihet dhe do të zëvendësohet me tekstin e mëposhtëm:

“KfW-ja ka të drejtë të refuzojë të kryejë disbursime pas datës 30 nëntor 2021.”;

b) Neni 3.1 do të fshihet dhe do të zëvendësohet me tekstin e mëposhtëm:

“KfW-ja nuk mund të pezullojë disbursime, përveç nëse:

a) Marrësi nuk përmbush detyrimet ndaj KfW-së për të kryer pagesat brenda afateve;

b) detyrimet sipas kësaj Marrëveshjeje ose Marrëveshjeve të ndara, pjesë e kësaj Marrëveshjeje, nuk janë respektuar;

c) Marrësi nuk mund të provojë se shumat e disbursuara janë përdorur për qëllimin e dakordësuar;

d) përmbushja e detyrimeve të KfW-së, sipas kësaj Marrëveshjeje, është në kundërshtim me ligjin në fuqi; ose

e) krijohen rrethana të jashtëzakonshme që pengojnë ose rrezikojnë seriozisht zbatimin, funksionimin ose qëllimin e Projektit.”;

c) neni 3.2 do të fshihet dhe do të zëvendësohet me tekstin e mëposhtëm:

“Nëse ka ndodhur ndonjë nga situatat e specifikuara në nenin 3.1 “b”, “c” ose “d” dhe nuk është eliminuar brenda një periudhe të përcaktuar nga KfW-ja, e cila, megjithatë, do të jetë të paktën 30 ditë, KfW-ja:

a) në rastin e nenit 3.1 “b” ose “d”, mund të kërkojë shlyerje të menjëhershme të të gjitha shumave të disbursuara;

b) në rastin e nenit 3.1 “c”, mund të kërkojë shlyerje të menjëhershme të atyre shumave për të cilat Marrësi nuk mund të provojë se janë përdorur për qëllimin e caktuar.”;

d) neni 7.5 do të fshihet dhe do të zëvendësohet me tekstin e mëposhtëm:

“Marrëdhëniet ligjore të vendosura nga kjo Marrëveshje ndërmjet KfW-së dhe Marrësit do të përfundojnë me mbarimin e kohëzgjatjes operationale të Projektit, por jo më vonë se data 31 dhjetor 2021.”.

Seksioni 3

Vazhdueshmëria

Të gjitha dispozitat e Marrëveshjes së Financimit do të mbeten të pandryshuara dhe do të vazhdojnë, përveç nëse amendohen nga kjo letër, në fuqi dhe efekt të plotë.

Seksioni 4

Dispozita plotësuese

4.1 Kjo letër nuk ndryshon ose heq dorë nga ndonjë dispozitë tjetër e Marrëveshjes së Financimit dhe në veçanti nuk përbën heqje dorë në lidhje me ndonjë nga të drejtat tona, sipas Marrëveshjes së Financimit, përveç siç përcaktohet qartë në këtë letër.

4.2 Dispozitat e nenit 4 (*Kostot dhe tarifat publike*), neni 5 (*Deklaratat kontraktuale dhe përfaqësimi ligjor*) dhe neneve 7.2, 7.3 dhe 7.4 (*Dispozita të ndryshme*), të Marrëveshjes së Financimit do të përfshihen në këtë letër sikur të jenë vendosur plotësisht në këtë letër dhe sikur referencat në këto klauzola të marrëveshjes të jenë referenca ndaj kësaj letre.

Ju lutem konfirmoni pëlqimin tuaj ndaj termave dhe kushteve të kësaj letre, duke nënshkruar në një format ligjërish detyrues siç tregohet më poshtë dhe duke i kthyer një origjinal KfW-së:

Me respekt,

KfW

Nënshkrimi
Pablo Obrador
Drejtues Divizioni
Energjia & Mobiliteti
Evropa Juglindore & Turqia

Nënshkrimi
Dr. Niels Kemper
Menaxher Portofoli
Energjia & Mobiliteti
Evropa Juglindore & Turqia

Në kopje

Ne pranojmë çështjet e përcaktuara në letrën tuaj të datës _____, nga e cila kjo është një kopje.

Për dhe në emër të Republikës së Shqipërisë
Përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Delina Ibrahimaj

MINISTËR I FINANCIVE DHE EKONOMISË

Datë 30 shtator 2021